



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 265/5 prot.

Tiranë, më 19.4.2025

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr.20, datë 29.4.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIME ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT TË
RISTRUKTURIMIT TË INSTITUCIONIT TË BASHKISË MIRDITË DHE
PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR SITUATËN
LIGJORE**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, i ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të ristrukturimit të Bashkisë Mirditë dhe transferimit të përhershëm të nëpunëses Elona Gjini,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën nr. 265 prot., datë 26.2.2025, të dërguar nga nëpunësja Elona Gjini, me detyrë “*Specialiste*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Qytetarët, Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Juridike dhe Marrëdhënieve me Qytetarët, në Bashkinë Mirditë, në të cilin ngrihen pretendime, për parregullsi të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit të Bashkisë Mirditë, finalizuar me aktin e transferimit të kësaj nëpunëseje në një pozicion tjetër pune, në këtë institucion.

Konkretisht, në përmbajtje të këtij informacioni dhe dokumentacionit bashkëlidhur tij, rezulton se, me aktin nr. 3454 prot., datë 8.8.2018, punonjësja në fjalë, është emëruar në

pozicionin e punës “Përgjegjëse”, në Sektorin e Rregullit të Brendshëm, në institucionin e Bashkisë Mirditë.

Me miratimin e strukturës së re, me Vendimin nr. 2 (nr. 90 prot.), datë 8.1.2024 “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë për vitin buxhetor 2024”, të Kryetarit të Bashkisë, për shkak të ndryshimeve të ndodhura në organizimin e disa drejtorive, organizimit të Agjencive, sipas afërsisë profesionale, afërsisë së objektit/ misionit, si dhe mundësisë optimale të menaxhimit të tyre, Bashkia Mirditë ka kaluar në proces ristrukturimi.

Në kuadër të këtij procesi, me aktin nr. 658/7 prot., datë 18.2.2024, të Kryetarit të Bashkisë, “Transferim për shkak të ristrukturimit”, është vendosur transferimi i nëpunëses Elona Gjini, nga pozicioni “Përgjegjëse”, në Sektorin e Rregullit të Brendshëm, në pozicionin “Specialiste”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Qytetarët, Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Juridike dhe Marrëdhënieve me Qytetarët.

Në lidhje me këtë transferim, punonjësja parashtron se, ai është kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit që normojnë institutin e transferimit në shërbimin civil, duke kërkuar saktësimin e statusit të saj të punësimit në institucionin e Bashkisë Mirditë.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit të institucionit të Bashkisë Mirditë.

Komisioneri pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja Elona Gjini, ka filluar procesin e verifikimit paraprak të informacionit të administruar dhe me shkresën nr. 265/2 prot., datë 10.3.2025 “Kërkim dokumentacioni për verifikimin e informacionit të dërguar me shkresën nr. 265 prot., datë 26.2.2025 në lidhje me ligjshmërinë e transferimit të përkohshëm të nëpunëses Elona Gjini, për shkak të ristrukturimit të institucionit të Bashkisë Mirditë” ka njoftuar institucionin e Bashkisë Mirditë, për fillimin këtij procesi, duke kërkuar njëkohësisht edhe dokumentacionin e plotë në të cilin është materializuar procesi i ristrukturimit të institucionit.

Në përgjigje të kësaj kërke, Bashkia Mirditë me shkresën e protokolluar pranë Komisionerit, me nr. 265/3 prot., datë 19.3.2025 “Dërgim dokumentacioni” ka dërguar dokumentacionin e kërkuar dhe nga analiza e përmbajtjes së tij rezulton se:

Procesi i ristrukturimit në Bashkinë Mirditë, është kushtëzuar nga miratimi i Vendimit nr. 2 (nr. 90 prot.), datë 8.1.2024 i Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë për vitin buxhetor 2024”, nëpërmjet të cilit ka ndryshuar mënyra e organizimit të disa drejtorive dhe Agjencive.

Sipas parashikimeve ligjore që materializohen në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, kreu II,

“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”; vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*; si dhe udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, të DAP *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*, i ndryshuar, procesi i ristrukturimit duhet të drejtohet nga njësi përgjegjëse e institucionit. Këto akte ligjore, nënligjore e rregullatore, e kanë vendosur njësinë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në krye të procesit të ristrukturimit të institucionit për t’u kujdesur në drejtim të respektimit të anës procedurale e ligjore të tij.

Njësi përgjegjëse është struktura që krijon Komisionin e Ristrukturimit dhe ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për emërimin e punonjësve që do të vijojnë të jenë pjesë e shërbimit civil, pas propozimeve të këtij organi.

Po kështu, kjo njësi është përgjegjëse edhe për trajtimin e punonjësve që do të lirohen nga shërbimi civil, për arsye se pozicioni i mëparshëm i punës në shërbimin civil nuk ekziston më; ose i ka ndryshuar përshkrimi i punës, ose i ndryshon regjimi juridik i marrëdhënies së punës, pas rivlerësimit të pozicioneve, duke nxjerrë aktin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, si dhe për të gjitha aspektet që kanë lidhje me dëmshpërblimin (*neni 66, pika 4/a, i ligjit*).

Procesi i ristrukturimit kalon në disa faza të cilat janë të përcaktuara qartë në bazën ligjore që përmendëm më sipër, të cilat do ti sjellim në vëmendjen tuaj në vijim, duke marrë parasysh faktin se ato nuk janë respektuar gjatë aplikimit të strukturës së re të institucionit. Të gjitha subjektet e ngarkuara prej ligjit për realizimin e procesit të ristrukturimit duhet të kryejnë detyrat e tyre duke ndjekur këtë rend pune:

- a. Të njoftohen individualisht nëpunësit që i përkasin institucionit që do të ristrukturohet, për fillimin e kësaj procedure, sipas përcaktimit të nenit 50/7, të ligjit dhe pikës 12, të aktit nënligjor që rregullon transferimin për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit.
- b. Të ngrihet Komisioni i Ristrukturimit (*me 3 anëtarë*), sipas përcaktimeve të nenit 50/3, të ligjit dhe pikës 12, të aktit nënligjor që rregullon transferimin për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, duke u kujdesur që të respektohet udhëzimi nr. 1, datë 01.03.2016, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*, i ndryshuar, i Departamentit të Administratës Publike, ku përcaktohen qartë rregullat e përgjithshme për krijimin dhe funksionimin e këtij mekanizmi sipas rastit të riorganizimit të institucionit, procedura që duhet të ndjekë, si dhe metodologjia e vlerësimit dhe sistemi i pikëzimit, që do të përdoret si analogji dhe do të mbështetet praktikisht në vendimmarrje ky Komision.

c. Komisioni i Ristrukturimit duhet të respektojë afatin 15 ditor, nga data e ristrukturimit, për të paraqitur relacionin me propozimet përkatëse përpara njësisë përgjegjëse, që kanë të bëjnë me:

- ✓ transferimin e nëpunësit civil sipas precedencës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;
- ✓ përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil (*lirimi nga shërbimi civil*) për arsyet e parashikuara në pikën 6, të nenit 50, të ligjit në fjalë;
- ✓ trajtimin financiar (*dëmshpërblimi*) për të gjithë nëpunësit, të cilët do të largohen për shkak të ristrukturimit, si dhe njohjen e të drejtës për periudhën 2-vjeçare, pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë (*neni 25 dhe 26 i ligjit*), si dhe të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil.

Puna e Komisionit të Ristrukturimit duhet të orientohet drejt analizës së të dhënave të nëpunësve civilë dhe kërkesave specifike të pozicionit të punës që kanë kryer, për punonjësit që kanë punuar në një pozicion që nuk ekziston më, duke i krahasuar ato, me përshkrimin e punës dhe kërkesat specifike për pozicionet e lira, apo të krijuara të reja pas ristrukturimit, si dhe në të gjitha aspektet e tjera që janë parashikuar me hollësi në udhëzimin e Departamentit të Administratës Publike, të përmendur më sipër.

d. Komisioni i ristrukturimit, në vendimin e tij për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, me qëllim që të respektojë parimet e administrimit të shërbimit civil, që kanë të bëjnë me profesionalizmin dhe meritën për të qenë pjesë e sistemit, si dhe për të garantuar qëndrueshmërinë në detyrë dhe vazhdimësinë e shërbimit civil, duhet të mbështetet mbi këto kritere:

- vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil;
- vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë;
- vlerësimin e fundit që ka pasur nëpunësi në testimin për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë.

e. Njësia përgjegjëse të respektojë afatin për transferimin e nëpunësit civil, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së propozimit nga Komisioni i ristrukturimit dhe të njoftojë nëpunësin civil për vendimin, për të marrë mendimin e tij me shkrim, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

f. Të respektohet procedura e dëgjimit nga ana e njësisë përgjegjëse, në rastet e refuzimit të vendimit të transferimit, nga ana e nëpunësit, të verifikohen shkaqet e refuzimit dhe të arsyetohet vendimmarrja në çdo rast.

Sipas dokumentacionit të administruar gjatë verifikimit të informacionit, rezulton se, **nuk është ngritur Komisioni i Ristrukturimit**, i cili është edhe organi që ligji e ngarkon me detyra të rëndësishme gjatë administrimit të procesit të ristrukturimit, e për pasojë, nuk janë zhvilluar proceset administrative që duhet të kryhen në këtë fazë, që janë:

- a) shqyrtimi i mundësisë së sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese;
- b) propozimi njësisë përgjegjëse, për transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike, sipas precedencës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013;
- c) marrja e vendimit për rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për arsyet e parashikuara në pikën 6, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar si dhe pikës 20, kreu II, të VKM-së nr. 125, datë 17.2.2016.

Për pasojë, aktet administrative nëpërmjet të cilave janë transferuar nëpunësit civilë pas ristrukturimit të institucionit, të nxjerra nga Drejtori i Njësisë së Burimeve Njerëzore dhe Kryetari i Bashkisë, kanë dalë në kundërshtim me kërkesat dhe procedurat ligjore të materializuara në aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative, që e dispiellojnë këtë proces.

Në rastin konkret, që është edhe objekt i hetimit administrativ, Njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e transferimit të përhershëm për shkak të ristrukturimit të institucionit për punonjësen Elona Gjini, duke mos respektuar një nga fazat më të rëndësishme procedurale, që është ngritja e Komisionit të Ristrukturimit dhe analiza e pozicioneve të punës për sistemimin e nëpunësve civilë pas ristrukturimit.

Në këto kushte, akti nr. 658/7 prot., datë 18.2.2024, për transferimin për shkak të ristrukturimit të nëpunëses Elona Gjini, “*Specialiste*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Qytetarët, Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Juridike dhe Marrëdhënieve me Qytetarët, ka dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil, si edhe duke mos respektuar procedurën specifike të përcaktuar nga ligji për këtë rast.

Po kështu, edhe konfirmimi i këtij akti të nxjerrë nga njësia përgjegjëse, nga ana e Kryetarit të Bashkisë, është një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, pasi është bazuar mbi një veprim të mëparshëm që është absolutisht i pavlefshëm.

Sa më sipër, akti administrativ objekt i hetimit administrativ, në zbatim të germës a), pika i) dhe ii), të nenit 108, “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, duhet të konstatohet si një akt absolutisht i pavlefshëm nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë.

Më tej, referuar nenit 110 dhe nenit 111, të ligjit nr. 44/2015, ku parashikohet se, ky akt nuk sjell asnjë pasojë juridike, vetë organet publike, që në këtë rast përkojnë me njësine përgjegjëse dhe Kryetarin e Bashkisë, duhet të konstatojnë pavlefshmërinë absolute të aktit

nr. 658/7 prot., datë 18.2.2024, për transferimin e përhershëm të nëpunëses Elona Gjini dhe të rregullojnë pasojat, duke e rikthyer nëpunësen në pozicionin e mëparshëm të punës.

Po kështu, në kushtet kur Komisioneri ka konstatuar se procesi i ristrukturimit nuk është kryer në përputhje me kërkesat dhe procedurat ligjore, të parashikuara në nenin 50 të ligjit nr. 153/2013 *”Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ky proces duhet të përsëritet për të gjithë nëpunësit civilë që janë përfshirë në të, duke filluar që nga faza e njoftimit të punonjësve për faktin se institucioni do të kalojë në një proces ristrukturimi, e më tej, të ngrihet Komisioni i Ristrukturimit, sipas përbërjes që e parashikon akti nënligjor përkatës, i cili duhet të realizojë detyrat e tij, dhe në përfundim njësia përgjegjëse të realizojë vendimarrjen sipas propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit, duke marrë edhe konfirmimin e pëlqimit nga nëpunësit civilë.

Për punonjësit që do të lirohen nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, duhet të mbahen parasysh të drejtat e nëpunësve për dëmshpërblim dhe për të marrë pjesë në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për një periudhë 2 vjeçare, ashtu si është trajtuar me hollësi më sipër.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 e 25 të Ligjit nr. 152/2013 *”Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 *”Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores *”Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Për të rregulluar ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë dhe njësia përgjegjëse, që në zbatim të nenit 108, 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015 *”Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, nëpërmjet një akti të ri me shkrim, të konstatojnë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 658/7 prot., datë 18.2.2024 *”Për transferimin për shkak të ristrukturimit”*, me anë të cilit është vendosur transferimi i nëpunëses Elona Gjini dhe të rregullojë pasojat duke e rikthyer nëpunësen në pozicionin e mëparshëm të punës.
2. Të përsëritet procesi i ristrukturimit, pas miratimit të strukturës së re, duke filluar nga faza e njoftimit të punonjësve për përfshirjen e institucionit në këtë proces dhe të respektohen kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore, si edhe afatet përkatëse për kryerjen e veprimeve të ndryshme procedurale, përgjatë gjithë fazave të këtij procesi,

ndër të cilat janë ngritja e Komisionit të Ristrukturimit, nxjerrja e aktit për transferim të përhershëm të nëpunësit civil, etj.

3. Njësia përgjegjëse, pranë Bashkisë Mirditë, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për kryerjen e veprimeve të mësipërme dhe të njoftojë Komisionerin për realizimin e detyrave që janë lënë në dispozitivin e këtij vendimi.
4. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 30 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Mirditë dhe nëpunësja Elona Gjini.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha